

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: "Blerje kompjutera dhe pajisje kompjuterike"

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 30200000- 1
Pajisje kompjuterike dhe furnizime

VLERA E FONDIT LIMIT: 2.087.288 (dy million e tetëdhjeteshtatë mijë e dyqind e tetëdhjete e tetë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë Sh.A (UKRK Sh.A), ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 ,me vlerë 41.745 (dyzet e një mijë e shtatëqind e dyzet e pesë) lekë (2% të vlerës së përlogaritur të kontratës).

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

K. Bojko

P. Zegullaj

E. Bicolli

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 834.915 lekë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndryshime.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet bazuar në dispozitat e sipërpërmendura ku përcaktohet:

Autoriteti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave **të xhiros vjetore** të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, **për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.** Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: **c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, si dhe sipas parashikimit të nenit 55 të Rregullave të PP.**

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare **konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.**

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Ajo i shërben UKRK Sh.A, për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, të Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.

Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

K. Bojko

P. Zegullaj

E. Bicolli

2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 417.457 leke pa TVSH (20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate) .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” me ndryshime. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55, pika 4, b ku përcaktohet shprehimisht, citojmë:

" Për kontratat e mallrave vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. ”

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën si më sipër, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar ($20\% \times 2.087.288 \text{ leke} = \mathbf{417.457 \text{ leke}}$) . Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor UKRK SH.A., për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës siç është parashikuar nga AK.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

K. Bojko

P. Zegullaj

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese katalogun e prodhuesit (te perkthyer dhe noterizuar) per mallrat objekt prokurimi. Në katalog, të markohet në menyrë të qartë dhe të dallueshme artikulli që oferton sipas modelit të deklaruar dhe të markohen edhe specifikimet përkatëse sipas DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të produktit që është objekt i prokurimit me qëllim që autoriteti kontraktor të vlerësojë nëse produkti i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pikën 6/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, për arsye të natyrës së mallrave që prokurohen dhe duke vlerësuar rëndësinë e tyre funksionale. Paraqitja e dëshmimeve si katalogët teknikë shërben si dëshmi për plotësimin e specifikimeve teknike nga operatorët ekonomikë dhe lidhet ngushtë me aftësinë zbatuese dhe natyrën e kontratës.

2.2.3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku të specifikojë se: mallrat e ofruara janë të reja dhe të pa perdorura më parë.

Argumentimi: Ky kriter është menduar, në mënyrë që AK të ketë garanci që ofertuesi do të paraqesë mallrat objekt kontrate në cilësinë e kërkuar nga AK, është vendosur në përputhje me pikën 6, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të plotësojë saktësisht kolonën me të dhënat teknike të mallrave te ofertuar në të gjitha tabelat e paraqitura në Shtojcën 5 (Specifikimet teknike) .

Mosplotësimi i sakte është element skualifikimi.

Argumentimi: Plotësimi i këtij kriteri është vendosur në vijim të përcaktimeve të Nenit 36 te Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, me qëllim shmangien e mundësive për keq-kuptimin dhe keq-referimin nga ofertuesi të specifikimeve teknike të produkteve të kërkuara. Kjo e garanton AK se ofertuesi e njih konkretisht produktin e kërkuar dhe merr përsipër paraqitjen e tij pa asnjë devijim nga sa kërkohet në DT. Ky kriter është vendosur bazuar në rëndësinë e veçantë që këto pajisje kanë në procedurën objekt prokurimi, është në proporcion me vlerën dhe natyrën e kontratës

Në funksion të plotësimit të Shtojcës “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emer, Mbiemer, Atësi, Amësi, Datëlindje, Vendlindje, Numër Personal, si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin/Administratorët e shoqërisë, Ortakun/Ortakët e shoqërisë, përfaqësues të ndryshëm të posaçëm të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.

K. Bojko

P. Zegullaj

Argumentimi: Sa me siper referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Autoriteti Kontraktor OST sh.a. ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik. Per këtë arsye, verifikimi i këtyre personave kërkon të dhëna të sakta si emër, mbiemër, atesi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuarçdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

K. Bojko

P. Zegullaj

Nr	Pershkrimi	Njësia	Sasia	Afati
1	Kompjutera desktop 1 sipas akshit	Cope	6	45 ditë
2	Kompjutera Workstation sipas akshit	Cope	1	45 ditë
3	Laptop Basic sipas Akshit	Cope	2	45 ditë
4	Printer All in One B&W sipas akshit	Cope	3	45 ditë
5	Switch me 5 porta	Cope	3	45 ditë
6	HDD Portable 1 TB	Cope	3	45 ditë
7	Kufje PC sipas akshit	Cope	3	45 ditë
8	Kamera PC sipas akshit	Cope	3	45 ditë
9	Antivirus me manaxhim te qenderzuar	Cope	25	45 ditë
10	Mouse wireless	Cope	3	45 ditë
11	Mouse USB	Cope	3	45 ditë
12	Tastiere USB	Cope	2	45 ditë
13	Koka Rrjeti RJ 45	Cope	50	45 ditë

Sasia e artikujve të sipërshënuar është përcaktuar duke u bazuar në nevojat e institucionit për këtë vit buxhetor.

Vendi i dorëzimit: Malli do të dorëzohet në Shoqerinë Rajonale Ujesjelles Kanalizime Korçë konform dokumentacionit ligjor dhe teknik të kërkuar nga autoriteti kontraktor dhe të marrë përsipër në ofertë nga ofertuesi.

K. Bojko

P. Zegullaj

1. DESKTOP 1 sipas AKSHI

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net:	7900 Pikë
“RAM”:	8 GB DDR4, min. 2666 MHz, Non-ECC
Madhësia e Solid-state Drive “SSD Size”:	500 GB SSD
“Disk Subsystem Controller”:	Serial ATA III 6 Gb/s
Karta Grafike “Graphics”:	Integrated graphic Card, min. 1 GB
“Media Device”:	DVD+/-RW
“Slots”:	Min. (3) PCI/PCI-E, nga të cilat min. (1) PCI-E 3.0 x16
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Portat e Komunikimit “Ports”:	Min. (6) USB nga të cilat: a. Min. (2) USB Para; b. Min. (4) USB 3.0 (1) RJ-45, (1) Audio In/Out, (1) Mic. and (1) Headphone, (1) Portë DP/DVI/HDMI/VGA
Rrjeti “Networking”:	(1) 10/100/1000 LAN Integrated Gigabit Ethernet Port
“Sound”:	Integrated Sound Card
“Speakers”:	Internal or Built-in Monitor
Siguria “Security Management”:	Embedded Security TPM 2.0
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”:	OEM Windows 10 64-bit Professional
Tastiera “Keyboard”:	Standart Keyboard QWERTY
“Mouse”:	Minimum 3 Button Scroll Optical
Ushqimi “Power Supply”	220 V AC, 50 Hz
Kursimi i Energjisë “Energy Efficiency”:	Energy Star
AKSESORËT	
Kabëll “Power Cord”:	Po, European
“Recover”:	Recover Partition
MONITORI	
Tipi “Type”:	LCD OSE LED i të njëjtës Markë me Kompjuterin
Madhësia “Size”:	≥ 21”
Rezolucioni “Native Resolution”:	1920 x 1080 at 60 Hz
Raporti i Kontratit “Contrast Ratio Static”:	1000:1
“Display Port”:	(1) VGA dhe të paktën (1) prej portave DP/DVI/HDMI
Koha e Rifreskimit “Response Time”:	≤ 6 ms
Kursimi i Energjisë “Energy Efficiency”:	Energy Star
Ushqimi “Power Supply”:	220 V AC, 50 Hz
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	3 Vjet

K. Bojko

P. Zegullaj

2. WORKSTATION - sipas AKSHI

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.netMin	10000 Pikë
“RAM”:	16 GB, min. DDR4-2666 MHz, ECC
Madhësia e Solid-state Drive “SSD Size”:	(1) x 256 GB SSD Sistemi Operativ dhe (2) x 1000 GB HDD
Shpejtësia e Hard Diskut “HDD Speed”:	7200 RPM SATA 6.0 Gb/s për HDD
“Disk Subsystem Controller”:	Serial ATA III 6.0 Gb/s, Minimum 4 Serial ATA Interface with RAID 0,1,5,10 Support. (Hard Disk të Konfiguruar në RAID 1).
Karta Grafike “Graphics”:	Kartë Grafike HD e Dedikuar PCI-E x16, Minimum 4 GB Memory; Min. (2) Porta (VGA/DVI/HDMI/DP, mund të përdoret dhe adaptor). Karta të jetë e rekomanduar dhe instaluar nga prodhuesi për workstation.
“Media Device”:	DVD+/-RW with Dual Layer DVD+R wri. Capacity
“Slots”:	Minimum (4) PCI/PCI-E nga të cilat min. (2) PCI-E x16
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Portat e Komunikimit “Ports”:	Min. (8) USB nga të cilat: a. Min. (2) USB Para; b. Min. (6) USB 3.0 (2) RJ-45, (1) Audio In/Out, (1) Mic. and (1) Headphone, (1) Portë Video (mund të përdoret dhe adaptor)
Rrjeti “Networking”:	(2) 10/100/1000 LAN Gigabit Ethernet Port
“Sound”:	Integrated Sound Card
“Speakers”:	Internal or Built-in Monitor
Siguria “Security Management”:	Embedded Security TPM 2.0
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”:	OEM Windows 10 64-bit Professional për Workstation
Tastiera “Keyboard”:	Standart Keyboard QWERTY
“Mouse”:	Minimum 3 Button Scroll Optical
Ushqimi “Power Supply”	220 V AC, 50 Hz
Kursimi i Energjisë “Energy Efficiency”:	Energy Star
AKSESORËT	
Kabëll “Power Cord”:	Po, European
“Recover”:	Recover Partition
MONITORI	
Tipi “Type”:	LCD OSE LED i të njëjtës Markë me Kompjuterin
Madhësia “Size”:	≥ 23”
Rezolucioni “Native Resolution”:	1920 x 1080 at 60 Hz
Raporti i Kontratit “Constrast Ratio Static”:	1000:1
“Display Port”:	(1) VGA ose DVI dhe (1) prej Portave DP/DVI/HDMI
Koha e Rifreskimit “Response Time”:	≤ 6 ms
Kursimi i Energjisë “Energy Efficiency”:	Energy Star
Ushqimi “Power Supply”:	220 V AC, 50 Hz
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	3 Vjet

K. Bojko

P. Zegullaj

3. LAPTOP Basic - sipas AKSHI

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.netMin	4500 Pikë
“Chipset”:	Intel ose Ekuivalent
“RAM”:	8 GB, DDR4 min. 2133 MHz, Non-ECC
Madhësia e Solid-state Drive “SSD Size”:	256 GB SSD
Karta Grafike “Graphics”:	Integrated Graphics with ≥ 1 GB Video Memory
“Media Device”:	DVD+/-RW
Ekрани “Display”:	15.6” LED FHD (1920 x 1080), Anti Glare
Bateria “Battery”:	Min. 45 Wh
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Portat e Komunikimit “Ports”:	Min. (3) porta USB nga të cilat min. (2) USB 3.0 (1) DisplayPort/HDMI (1) Integrated Mic. (1) Integrated HD Web Camera (1/1) Headphone/Microphone Jack ose (1) Combo Jack
Rrjeti “Networking”:	10/100/1000 Mbps LAN (RJ-45); Wireless 802.11ac (Kompatibël me 802.11 b/g/n); Bluetooth min. V4.0
“Sound”:	Integrated , (2) x built-in speakers (stereo)
Siguria “Security Management”:	Embedded Security TPM 2.0
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”:	OEM Windows 10 64-bit Professional
Tastiera “Keyboard”:	QWERTY
“Pointing Device”:	Touch pad
AKSESORËT	
Kabëll “Power Cord”:	Po, European
Ushqyesi “Recharger”:	Po
“Mouse”	Po, i të njëjtës Markë me Laptopin
Çanta “Carrying Bag”:	Po, nga Prodhuesi. E përshtatshme për Laptop dhe Aksesorët e tjerë.
“Recover”:	Recover Partition
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	3 Vjet

4. PRINTER - All In One B&W sipas AKSHI

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
"Model":	Print, Scan, Copy
Shpejtësia e Printimit “ Print Speed” A4:	≥ 20 ppm
Cikli Mujor i Punës “Monthly Duty Cycle”:	8 000 Fage
Teknologjia “Technology”:	Laser
Rezolucioni i Printimit Minimal “Print Quality”:	600x600 dpi
Kapaciteti në Hyrje “Input Capacity”	150 Fletë
Formati i Letrës “Media format”:	A4
Memorja “Memory”:	≥ 64 MB
Rezolucioni Minimal Optikal i Skanimit "Min. Optical Scan Resolution":	600x600 dpi
“Toner”:	Shoqëruar me Starter Kit
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Porta e Komunikimit “Interface”:	High Speed USB 2.0
“Ethernet”:	Po

AKSESORËT	
Kabëll "Power Cord":	Po, European
Software/Drivers CD :	Po
Kabëll USB:	Po
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë "Warranty":	1 Vit
Pjesët e konsumueshme janë drum-i dhe toneri.	

5. SWITCH - Me 5 Porta sipas AKSHI

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Tipi, "Type":	Switch Gigabit i Pa Menaxhueshëm 5 Porta
Numri i Portave Ethernet, "Number of Ethernet Ports":	5 Porta Gigabit
Menyrat e Forward-im, "Forwarding modes":	Store-and-forward
Protokollet e Rrjetit IEEE, "IEEE Network Protocols":	IEEE 802.3 Ethernet IEEE 802.3ab 1000BASE-T
Certifikimi i produktit, "Certification":	CE mark
Aksesorët e Përfshirë, "Accessories Included":	Power Supply Power Adapter Quick Install Guide
Periudha e Mbulimit të Garancisë "Warranty":	1 Vit

6. HDD I JASHTËM 1 TB

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Kapaciteti	1 TB
Ndërfaqja e transferimit	USB 3.0
Madhësia paisjes (kasës)	2.5 inch
Përputhshmëria me OS	Windows 7 e sipër
Driverat	Linux, Windows, Mac
Opsione	Mundësi enkriptimi me password
Periudhën kohore të mbulimit të garancisë	1 vit

7. KAMERA - Web-i Për Komputera sipas AKSHI

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
"Model":	Webcam, Min. Full HD 1080P
Autofocus:	Po
Mikrofon i integruar:	Jo i detyrueshëm
Ndërfaqja me kompjuterin:	USB tipi A
Field of view:	Min. 78°
Mënyra e instalimit:	Automatikisht (pa pasur nevojë për drivera)
Sistemi i Operimit të suportuar:	Windows 10 64-bit Prof. dhe me i mire, Mac
Mënyra e vendosjes:	Mbi ekran
Gjatësia e kabullit:	Min. 1.5 m
Periudha e Mbulimit të Garancisë "Warranty":	6 Muaj

K. Bojko

P. Zegullaj

8. KUFJE - Me Mikrofon Për Kompjutera sipas AKSHI

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
"Model":	Kufje rreth kokës, për të dy veshët me mikrofon
Veçoritë:	Të jetë fleksibël për të ndryshuar përmasat (zmadhim, zvogëlim). Të ofrojë mundësinë e kontrollit të volumit. Mikrofondi të ofrojë reduktimin e zhurmave.
Tipi i lidhjes me kompjuterin:	USB tipi A
Gjatësia e kabullit:	Min. 1.8 m
Përshtatshmëria:	Windows, Mac.
Periudha e Mbulimit të Garancisë "Warranty":	6 Muaj

9. Antivirus me menaxhim të qëndërzuar

Periudha e vlefshmerise – 24 muaj

Sistemi duhet të ketë këto karakteristika:

- Sistemi i antivirusit të jetë me një menaxhim qëndror me një konsolë të vetme për të bërë monitorimin dhe menaxhimin e të gjithë kompjuterave.
- Ky sistem përbëhet nga agjentët të cilët instalohen në secilën pajisje të çdo përdoruesi dhe menaxhohet nëpërmjet konsolës qëndrore në ndërfaqe web.
- Të jetë gjithmonë në gjurmim të kërcënimeve.
- Të kryejë monitorimin e aplikacioneve "non-browser" për trafik HTTP dhe të bllokojë ato në rast detektimi.
- Të ofrojë mundësinë e zbulimit të software-ve të rrezikshëm si dhe versioneve të pa suportuara të tyre për të gjitha pajisjet pc/sever me system operimi windows/mac/linux që mund të çenojnë sigurinë e rrjetit.
- Sistemi me menaxhim qëndror duhet të jetë e aftë të gjenerojë raporte të detajuara ditore, javore dhe mujore.
- Sistemi i antivirusit duhet të jetë i integrueshëm me infrastrukturën e rrjetit dhe me sistemet e operimit të endpointeve dhe serverave (windows, linux).
- Sistemi i antivirusit duhet të ofrojë mbrojtje real-time, zbulim të përshpejtuar kundrejt kërcënimeve si: viruseve, malwareve, trojaneve, spyware etj. dhe gjithashtu përgjigje të përshpejtuar duke bërë fshirje automatike.
- Sistemi i antivirusit duhet të ofrojë mbrojtje non-stop nga Ransomware kundër kërcënimeve lokale dhe atyre remote duke parandaluar dhe bllokuar enkriptimin e skedareve për pajisjet endpoints dhe servera me sistem operimi windows dhe linux si dhe të bëjë sprapsjen e menjëhershme të sulmit duke rikthyer skedarët në gjendjen e mëparshme.
- Në rast sulmi, sistemi i antivirusit duhet të jetë i aftë të izolojë automatikisht pajisjet nga komunikimi në rrjet.
- Sistemi i antivirusit duhet të mundësojë mbrojtjen e memories dinamike të kompjuterëve dhe serverave si kundërpërgjigje në rast sulmi.
- Sistemi i antivirusit duhet të mundësojë fshirjen dhe bllokimin e një kërcënimi specifik në mënyrë sa më të thjeshtë dhe praktike në rastet kur i njëjti kërcënim detektohet edhe në disa pajisje të tjera brenda rrjetit.
- Të përdori format më të avancuara të "machine learning" për të zbuluar malware-t dhe për të bërë të mundur kontrollin mbi skedarët e ekzekutueshëm përpara ekzekutimit të tyre.
- Sistemi i antivirusit duhet të parandalojë dhe bllokojë sjelljen anormale dhe keqdashëse të aplikacioneve.
- Sistemi i antivirusit duhet të parandalojë vjedhjen e kredencialeve.

K. Bojko

P. Zegullaj

- Sistemi i antivirusit duhet të ofrojë teknikat më të fundit zbuluese për kërcënimet, edhe teknikat mbrojtëse në rast të një sulmi të pranishëm.
- Duhet të sigurojë mbrojtjen nga vjedhjet e kredencialeve dhe përdorimi i kodeve arbitrare.
- Sistemi i antivirusit duhet të kryejë monitorim të sigurtë të web browserit dhe ndërfaqeve të rrjetit.
- Sistemi i antivirusit duhet të mundësojë kontrollin në web të përdoruesve fundorë nëpërmjet zbatimit të filtrave specifike të webit duke i kategorizuar ato sipas modifikimeve të administratorit.
- Sistemi i antivirusit duhet të ofrojë mbrojtje ndaj sulmeve dhe shfrytëzimit të sektorit të boot-imit.
- Sistemi i antivirusit duhet të ndalojë përdoruesin fundor nga përdorimi i pajisjeve të jashtme të paautorizuara harduerike, removable storage media, pajisjet e teknologjise më të fundit wifi etj.
- Sistemi duhet të mundësojë politika sigurie për bllokimin e aplikacioneve specifike tek përdoruesit fundor ose tek një grup i caktuar përdoruesish.
- Sistemi i antivirusit duhet të bllokojë transferimin e fileve specifike që përmbajnë të dhëna sensitive.
- Të parandalojë humbjen, keqpërdorimin ose aksesin e paautorizuar të të dhënave nëpërmjet monitorimit non-stop dhe kufizimit të transferimit të skedarëve në rast nevojë.
- Sistemi i antivirusit duhet të bëjë analizimin dhe skanimin e signatur-ave dhe kodeve për të zbuluar variantet e malware.
- Sistemi i integruar duhet të mundësojë që pajisjet fundore, ashtu sikur serverat të ndajnë vazhdimisht dhe në mënyre sinkrone informacione në rrjet.
- Sistemi i antivirusit duhet të ketë në përbërje komponente që monitorojnë non-stop trafikun HTTP/S për lidhjet e mundshme të përdoruesit fundor me serverat dhe URL e rrezikshme.

10. MOUSE WIRELESS

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Transmetim wireless	≤ 10 metër
DPI	1600
Butonat	2 butona 1 rrotë lëvizëse
Jetëgjatësia e baterisë	≤ 1 vit

11. MOUSE USB

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Lloji i ndërfaqes	USB
DPI	1600
Butonat	4 butona 1 rrotë lëvizëse
Gjatësia e kabllit	1500 mm
Sistemi i operimit	Windows 7 e sipër dhe Mac OS 10.3 e sipër

12. TASTIERË USB

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Lloji i ndërfaqes	USB
Numri i tasteve	104
Madhësia	470x150x26mm
Gjatësia e kabllit	1500 mm
Sistemi i operimit	Windows 7 e sipër dhe Mac OS 10.3 e sipër

K. Bojko

P. Zegullaj

13. KOKA RRJETI RJ45

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Tipi	RJ-45 Cat. 5
Funksioni	Për krijimin e kablove të rrjetit internet
Cilësia e transferimit	Cat. 5E
Materiali	Plastike
Garancia	1 vit

Afatet e lëvrimit:

Afati i lëvrimit do të jetë: 45 ditë kalendarike, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës. Mallrat duhet të dorëzohen tek UKRK Sh.A.

K. Bojko

P. Zegullaj